

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8328, DATË 16.4.1998, “PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË TË PARABURGOSURVE”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në kuadër të luftës pa kompromis ndaj krimit të organizuar është hartuar ky projektligj në lidhje me mënyrën e trajtimit të individëve që janë subjekte të këtij lloji të kriminaliteti. Qëllimi i këtij projektligji është rritja e masave të sigurisë dhe të drejtave të të dënuarve e të paraburgosurve për raste të veçanta, duke iu nënshtruar një regjimi të posaçëm të ushtrimit të të drejtave.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është i parashikuar në programin analitik të projektakteve, por miratimi i tij vjen si një domosdoshmëri për trajtimin e rasteve problematike të hasura në praktikë.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Politika penale, për sa i përket trajtimit të këtyre veprave penale, të kryera nga këta subjekte, duhet të fokusohet më së shumti në ashpërsimin e dënimit. Por, praktika e vendeve të tjera ka treguar se ashpërsimi i dënimit nuk mjafton për të luftuar këtë fenomen. Për këtë qëllim, është i nevojshëm edhe miratimi i një sërë rregullash për mënyrën se si duhet të trajtohen këto subjekte gjatë gjithë periudhës, duke filluar që nga kryerja e hetimeve paraprake dhe deri në përfundim të ekzekutimit të dënimit me burgim.

Përcaktimin e këtyre subjekteve e bën neni 28, i Kodit Penal, që trajton format e veçanta të bashkëpunimit, duke radhitur, në këtë aspekt, grupin e strukturuar kriminal, organizatën kriminale, bandën e armatosur dhe organizatën terroriste. Sipas pikës 5, neni 28, të Kodit Penal, krijimi dhe pjesëmarrja në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar

kriminal cilësohen si vepra penale dhe dënohen sipas parashikimeve të pjesës së posaçme të këtij Kodi ose të dispozitave të tjera penale të veçanta. Ndërsa, sipas pikës 6, të po këtij neni, anëtarët e organizatës kriminale, të organizatës terroriste, bandës së armatosur ose grupit të strukturuar kriminal janë përgjegjës për të gjitha veprat penale të kryera prej tyre në përmbushjen e qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale.

Duke u nisur nga përcaktimi i nenit 28, të Kodit Penal, legjislatori ka përcaktuar vendosjen e subjekteve të krimit të organizuar, me qëllim ekzekutimin e dënimit me burgim, në një burg të sigurisë së lartë. Përveç kësaj kategorie, në burgun e sigurisë së lartë, sipas parashikimeve të bëra në nenin 13, të ligjit nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, vendosen edhe të dënuar të tjerë, të cilët, në kryerjen e veprës penale ose gjatë vuajtjes së dënimit janë karakterizuar nga qëndrime e sjellje që bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera.

Sipas këtij parashikimi, në burgun e sigurisë së lartë vendosen direkt nga gjykata, në momentin që jep vendimin, subjektet e krimit të organizuar, ndërsa, për të dënuarit e tjerë mund të lihet në dorë të gjykatës nëse është vendi për të vendosur këta të dënuar në burgun e sigurisë së lartë apo jo. Për këtë kategori të dytë, legjislatori ka parashikuar në nenin 13, të ligjit nr.8328, se, kur gjykata nuk është shprehur me vendim për vendin ku do të vuhet dënimi dhe është rasti që dënimi të vuhet në burg të sigurisë së lartë, atëherë kjo bëhet me kërkesë të prokurorit tek ajo gjykatë.

Në bazë të pikës 3 të nenit 13, të ligjit nr.8328, në burgjet e sigurisë së lartë, vihen kufizime në të drejtat e të dënuarit, në rastet dhe sipas kritereve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj. Nisur nga ky parashikim dhe në kuadër të situatës emergjente që po kalon lufta ndaj krimit të organizuar në Shqipëri, Ministria e Drejtësisë vendosi të hartojë këtë projektligj, me qëllim kufizimin e të drejtave të të dënuarve që janë pjesë e krimit të organizuar.

Për këtë arsye, është menduar që pas nenit 13, të ligjit nr.8328, të shtohet neni 13/1, “Regjimi i posaçëm i ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë”.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në përputhje me nenin 26, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ministri i Drejtësisë është autoriteti i deleguar për propozimin e këtij projektligji. Ndaj dhe nisma e propozuar paraqitet

si një iniciativë për shqyrtim e miratim nga Këshilli i Ministrave, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk përafrohet asnjë akt të *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në paragrafin e parë është bërë një përcaktim i saktë i neneve për të cilat duhet të zbatohet ky regjim i posaçëm. Këto nene dënojnë jo vetëm krijimin dhe pjesëmarrjen në një organizatë kriminale, organizatë terroriste, bandë të armatosur ose grup të strukturuar kriminal por edhe veprat penale të kryera nga anëtarët e krimit të organizuar në kuadër të përmbushjes së qëllimeve të veprimtarisë së tyre kriminale. Më pas, po në këtë paragraf, janë parashikuar një sërë masash që duhet të ndërmerren edhe ndaj të dënuarve për këto vepra penale edhe ndaj të paraburgosurve që hetohen apo gjykohen për këto vepra penale.

Përcaktimi i këtyre masave është bazuar në nenin 41 bis të ligjit italian për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve. Ky nen është marrë në shqyrtim disa herë edhe nga GJEDNJ-ja dhe është cilësuar për mënyrën e zbatimit të tij në përputhje me orientimet e KEDNJ-së dhe të vetë GJEDNJ-së.

Mënyra e zbatimit të këtyre masave në realitetin shqiptar është paksa më ndryshe nga mënyra e zbatimit të tyre në realitetin italian. Gjithsesi, ajo që vlen të përmendet lidhet me faktin se zbatimi i këtyre masave në realitetin shqiptar është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe, ajo që është më e rëndësishme, në përputhje me orientimet e KEDNJ-së dhe GJEDNJ-së.

Sipas këtyre orientimeve, kufizime të tilla të të drejtave duhet të ndërmerren vetëm për situata emergjente dhe të kenë një kohëzgjatje të përcaktuar, pas së cilës mund të rivlerësohen kushtet dhe kriteret për zbatimin e këtij regjimi.

Në kushtet e realitetit shqiptar, nisur edhe nga detyrat që BE-ja i ka ngarkuar Shqipërisë në luftën kundër krimit të organizuar, ky fenomen përbën një situatë emergjente. Për këtë arsye, që në fillim, nëse një person do të arrestohet dhe do të gjykohej për këto vepra penale, ai duhet të vendoset në një regjim të posaçëm me kufizim të të drejtave, me qëllimin për të të parandaluar:

- a) kontaktet me organizatën kriminale ku bën pjesë apo me organizata të tjera aleate;
- b) konfliktet e mundshme me elementë të organizatave kundërshtarë;

- c) ndërveprimin me të burgosurit apo të paraburgosurit e tjerë, që i përkasin të njëjtës organizatë ose të organizatave të tjera me të cilat ata bashkëpunojnë.

Kjo periudhë nuk mund të jetë më e gjatë se 1 vit. Për këtë arsye, edhe në përputhje me orientimet e GJEDNJ-së, është përcaktuar e drejta e ministrit të Drejtësisë, që, më kërkesë të të dënuarit apo të paraburgosurit, të bëjë një rivlerësim të kushteve për vazhdimësinë e këtij regjimi të posaçëm. Në projektligj janë parashikuar edhe kriteret se ku duhet të bazohet vendimi i ministrit të Drejtësisë për rivlerësimin e situatës. Pas rivlerësimit të kushteve dhe urdhrimit të ministrit të Drejtësisë për vazhdimin e këtij regjimi të posaçëm për një periudhë tjetër 1-vjeçare, i dënuari, i paraburgosuri apo avokati mbrojtës kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatë, nëse e shikojnë të arsyeshme.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë ministri i Drejtësisë, ministri i Brendshëm, organet e sistemit të drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Drejtësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk sjell efekte financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE